

SAT Test Directions

Translated into Albanian for Students

Notes to the Proctor

Your school may be offering both the SAT without Essay and SAT with Essay. College Board allows schools to combine students with both test options in a single standard room. This translated script includes test directions for EL students testing in an uncombined room and a combined room.

Printing this document for your students

- If testing in a standard room that is UNCOMBINED, or in an ACCOMMODATED room, print the Notes to the Proctor, Notes to the Student, Standard SAT Script, and Standard Script for Uncombined Rooms. Omit Standard Script for Combined Rooms.
- If testing in a standard room that is COMBINED, print the Notes to the Proctor, Notes to the Student, Standard SAT Script, and Standard Script for Combined Rooms. Omit Standard Script for Uncombined Rooms.

Using this document on test day

Distribute this document once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book. Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period. Students may **not** be given additional time, unless approved by College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

Shënime për studentin

Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që kujdestari juaj do t'i lexojë me zë, si dhe udhëzimeve të shkruara që gjenden në librat e testit tuaj. Përcillni udhëzimet derisa kujdestari juaj i lexon ato me zë në anglisht. Nëse keni pyetje rreth asaj se çfarë është duke lexuar kujdestari juaj, ju lutem ngrisni dorën.

- Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përshtaten fjalë për fjalë me atë që lexon kujdestari juaj; megjithatë informatat e rëndësishme janë të njëjta.
- Kujdestari juaj mund të kapërcejë disa udhëzime që nuk vlejné për situatën tuaj të testimit.
- Mund ta mbani këtë dokument në tavolinë gjatë gjithë kohës së testimit por duhet t'ia ktheni kujdestarit tuaj pas testimit.
- MOS e përdorni këtë dokument për letër planifikimit të përgjigjes.
- Në kohë të ndryshme, kujdestari juaj do të lajmërojë sa është koha e mbetur për pjesën, si dhe për pauzat kur të jetë e përshtatshme. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, këto lajmërime mund të dallojnë sa i përket kohës dhe pauzave të listuara në këtë dokument të përkthyer. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj.
- Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, kujdestari i juaj mund të ju jep udhëzime shtesë në gjuhën angleze.
- Ikonat përdoren përgjatë tërë këtij dokumenti për të ju tërhequr vëmendjen në informata specifike:



Informatë e rëndësishme.



Udhëzimet që përmban libri juaj i testimit

I gjithë teksti i hijezuar tregon udhëzimet e thëna nga kujdestari juaj

Përmbajtja

Notes to the Proctor 1

Shënime për studentin 2

Skripta SAT Standarde 4

Para fillimit të testit 4

Shpërndarja e fletës së përgjigjeve 6

Shpërndarja e Librit të Testit 7

Udhëzimet në Ballinë 9

Udhëzimet në kopertinën e pasme 10

Skripta standarde për Klasa të Pakombinuara 11

Pjesa 1: Testi i leximit 11

Deklarata e vërtetimit 12

Pjesa 2: Testi i Shkrimit dhe Gjuhës 13

Pjesa 3: Testi i Matematikës – Pa Kalkulator 14

Pjesa 4: Testi i Matematikës – Kalkulator 18

Eseja 22

Skripta standarde për Klasa të Kombinuara 28

Pjesa 1: Testi i leximit 28

Deklarata e vërtetimit 29

Pjesa 2: Testi i Shkrimit dhe Gjuhës 30

Pjesa 3: Testi i Matematikës – Pa Kalkulator 31

Pjesa 4: Testi i Matematikës – Kalkulator 35

Eseja 41

1 Skripta SAT Standarde

1.1 Para fillimit të testit

Kujdestari juaj do të nisë duke thënë:

Mirëmëngjesi. Siç e dini, jeni këtu për t'iu nënshtruar SAT-it. Urime për marrjen e këtij hapi të rëndësishëm drejt kolegjit dhe synimeve në karrierë.

Para se të nisim testin, do të lexoj disa udhëzime. Kjo do të zgjasë rreth 20 minuta. Ju lutem dëgjoni me kujdes dhe ngriteni dorën nëse keni ndonjë pyetje. Mbani mend, roli im është të sigurohem që keni mundësinë më të mirë për të demonstruar shkathësitë dhe njohuritë tuaja.

Nëse jeni duke përdorur udhëzimet e shtypura, hapni broshurën tani për të më ndjekur derisa i jap udhëzimet.

Kujdestari juaj do të vazhdojë duke thënë:

Kushtet e përgjithshme të College Board SAT përfshijnë rregulla dhe politika për të siguruar që të gjithë studentët të kenë një përvojë testuese të drejtë dhe të barabartë. Të gjithë në këtë klasë sot janë përgjegjës të ndihmojnë që kjo të ndodhë. Nëse ndokush shqetëson të tjerët ose përpiqet të fitojë avantazh të padrejtë, do t'i kërkojë të largohet nga klasa dhe rezultatet e tyre do të zhvlerësohen. Atyre gjithashtu mund t'u ndalohej t'u nënshtrohen testeve tjera të College Board në të ardhmen.

Kujdestari juaj do të listojë shembuj të sjelljes së keqe duke thënë:

Këtu kemi disa shembuj të avantazheve të padrejta:

- Dhënia ose pranimi i çfarëdo lloji ndihme
- Shikimi i librit të testit para se të fillojë koha
- Shikimi në cilëndo pjesë tjetër përveç asaj në të cilën gjendemi tani
- Shënjimi ose ndryshimi i përgjigjeve pas përfundimit të kohës
- Tentativa për të larguar materiale të testit nga klasa e testimit
- Posedimi i celularit ose çfarëdo ndihme tjetër të paautorizuar për testin gjatë testimit ose gjatë pauzave
- Përdorimi i çelësit të përgjigjeve ose ndarja e përgjigjeve me këdo gjatë ose pas testit
- Shkuarja te dollapi me dry ose largimi nga ndërtesa gjatë testit
- Tentimi për t'iu nënshtruar testit për dikë tjetër
- Ngrënia ose pirja gjatë testimit pa akomodim të miratuar për të bërë këtë
- Shkaktim shqetësimi
- Mosndjekja e procedurave të testimit

Këto politika ndihmojnë që të sigurohet se përvoja e testimit tuaj sot të jetë e drejtë dhe se mund të fokusoheni në testin tuaj pa shpërqëndrime.

(A) Nëse shkolla juaj ka mbledhur gjërat personale të studentëve, kujdestari juaj do të thotë:

Deri tani ju do të duhej të kishit dorëzuar të gjithë telefonat dhe çfarëdo pajisje tjetër elektronike. Nëse ndokush ende ka ndonjë pajisje elektronike të çfarëdo lloji, përfshirë orë dore të mençur ose monitorues fitnesi, ju lutem çaktivizoni alarmet, fikini dhe mi dorëzoni mua tani e në fund të testit do të ju kthehen.

(B) Nëse shkolla juaj nuk lejon mbledhjen e gjërave personale të studentëve, kujdestari juaj do të thotë:

Në këtë kohë, nëse keni telefon apo ndonjë pajisje tjetër elektronike në posedim, përfshirë orë dore të mençur ose monitorues fitnesi, duhet t'i çaktivizoni alarmet, t'i fikni pajisjet dhe ti fusni në qese apo çantë e ti vendosni anash në klasë deri në përfundim të testit. Nëse ju duhet qese plastike për ta vendosur telefonin, ngriteni dorën dhe unë do t'ua jap një.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Çfarëdo pajisje elektronike që nuk është e fikur dhe e lënë larg mund të mblidhet dhe të kontrollohet përmbajtja e tyre si pjesë e një hetimi tërësor. Nëse shiheni me ndonjë pajisje ose nëse pajisja juaj bën ndonjë zhurmë ose krijon shqetësim ndërsa është në posedimin tuaj, do të më duhet të ju largoj nga testimi. Nga tani e tutje, do ta largoj cilindo student që e shoh me telefon, orë dore të mençur ose pajisje tjetër elektronike.

Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:

Faleminderit që u kushtuat vëmendje këtyre udhëzimeve. Tani, ju do t'i pastroni tavolinat për testim.

- Largoni çdo gjë nga tavolina juaj përveç lapsave Numër 2 me goma, kalkulatorëve të pranueshëm, ose fjalorëve nga fjala në fjalë, nëse jeni duke përdorur një të tillë.
- Nëse keni sjellë me vete bateri shtesë, pije, ose zamra, vendosni në dysheme nën tavolinë.
- Nëse në tavolinë ju ka mbetur ndonjë qese ose çantë shpine, mbyllini ato dhe vendosini anash në klasë deri në përfundim të testimit.

Kur të gjithë studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:

Tani për disa momente do të kontrolloj përreth dhe të sigurohem se të gjithë ju jeni duke përdorur kalkulatorë të pranueshëm.

Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem mbani mend se nuk mund të ndani ose shkëmbeni kalkulatorët në asnjë moment. Vendoseni kalkulatorin tuaj nën tavolinë tani. Nuk do të ju nevojitet deri në një pjesë tjetër.

1.2 Shpërndarja e fletës së përgjigjeve

Nëse shkolla juaj ka mbajtur një sesion preadministration, kujdestari juaj do të sigurohet që secili student të marrë fletën e vet të përgjigjeve me informatat identifikuese. Cilido student që nuk ka marrë pjesë në sesionin preadministration do të marrë fletën e tyre të përgjigjeve të paraetiketuar. Cilido student që nuk ka fletë të përgjigjeve të paraetiketuar do të marrë një fletë të përgjigjeve të zbrastë.

Pas shpërndarjes së fletëve të përgjigjeve, kujdestari juaj do të thotë:

Këto janë fletët e përgjigjeve që do t'i përdorni për të shënuar përgjigjet e juaja në test. Nëse jeni duke përdorë një fletë të përgjigjeve të madhe, lexoni udhëzimet në faqen e parme lidhur me atë se si t'i shënjoni përgjigjet e juaja. Numrat e faqeve tuaja do të jenë të ndryshëm nga ata që unë do t'i lajmëroj, por numrat e fushave do të jenë të njëjtë si numrat e fushave që i jap për të gjithë. Do t'i shënjoni katrorët me një X në vend se të mbushni fluskat.

Ju lutem kontrolloni të siguroheni se emri i saktë ligjor i juaji është i paraqitur në fletën e përgjigjeve. Nëse fleta juaj e përgjigjeve ka një etiketë në të, ju lutem kontrolloni se a është i paraqitur emri i saktë ligjor i juaji. Ngriteni dorën nëse keni fletën e gabuar të përgjigjeve ose nëse emri i juaj është i pasaktë në etiketë.

Kujdestari juaj do të thotë:

Nëse fleta juaj e përgjigjeve ka të plotësuar emrin tuaj të saktë dhe informatat tjera, ju lutem rrini ulur të qetë për disa minuta derisa i udhëzoj studentët tjerë për të plotësuar fushat e kërkuara në fletët e tyre të përgjigjeve.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Plotësoni emrin e plotë ligjor tuajin në fushën 1 tani. Përfshini hapësirat, vizat ose apostrofët nëse janë pjesë e emrit tuaj. Në kuti shkruani shkronja të mëdha të shtypit, pastaj mbushni fluskat përkatëse. Sigurohuni që çdo shenjë është e errët dhe e mbush tërësisht fluskën. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Për fushën 2, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse ju duhet të plotësoni fushën 2, dhe e vijoni këtë shkollë, shënoni kodin tonë gjashtëshifror të shkollës _____ në fushën 2 dhe mbushni fluskat korresponduese. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Nëse nuk e vijoni këtë shkollë ose jeni i shkolluar në shtëpi, ngriteni dorën. Do të vij t'ua jap kodin e saktë për ta plotësuar në fushën 2.

Për fushat 3 dhe 4, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse ju duhet të plotësoni fushat 3 dhe 4 dhe e vijoni këtë shkollë, mbushni fluskat për "Yes" në fushën 3 dhe shënoni emrin e shkollës sonë, qytetit dhe shtetit në fushën 4. Nëse nuk e vijoni rregullisht këtë shkollë, mbushni fluskën që vlen për ju në fushën 3 dhe shkruani informatat për shkollën tuaj në fushën 4. Ngriteni dorën nëse nuk jeni të sigurt çfarë të plotësoni.

Për fushën 5, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse fusha 5 është e zbrastë, shkruani me shkronja shtypi dhe mbushni fluskën e numrit të letërnjoftimit të studentit, duke filluar me kolonën e parë në të majtë. Numrin e letërnjoftimit të studentit mund ta gjeni në këndin e epërm të majtë

të etiketës. Nëse ka shkronja në numrin e letërnjoftimit tuaj mos i përfshini ato dhe futni vetëm numrat pa hapësira mes tyre. Nëse nuk e dini numrin e shtetit të letërnjoftimit tuaj të studentit, ju lutem ngriteni dorën. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Për fushën 6, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse fusha 6 është e zbraztë, mbushni flluskën për klasën tuaj aktuale në fushën 6.

Për fushën 7, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse fusha 7 është e zbraztë, mbushni flluskën për muajin në të cilin keni lindur. Në fletët e mëdha të përgjigjeve, plotësoni shifrat për muajin, duke filluar me zeron nëse muaji ka vetëm një shifër. Mandej, shkruani numrin 2 shifror për ditën në të cilën keni lindur, duke filluar me zero nëse dita është më pak se 10. Pastaj shkruani 2 shifrat e vitit në të cilin keni lindur. Mbushni flluskat përkatëse dhe ngriteni shikimin kur të përfundoni.

Për fushën 8, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse fusha 8 është e zbraztë, shënjoni flluskën e saktë në fushën 8.

Para shpërndarjes së librave të testit, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse keni fusha tjera që duhet ti plotësoni në pjesën që nuk është test të fletës suaj të përgjigjeve, do të keni mundësi t'i plotësoni ato pasi të përfundojë testi.

1.3 Shpërndarja e Librit të Testit

Tani kujdestari juaj do të thotë:

Tani do t'i shpërndaj librat e testit. Mos i hapni derisa të ju them që ta bëni këtë.

Kujdestari juaj do të vazhdojë duke thënë:

Kur të merrni librin e testit kthejeni përmbys dhe shkruani me shkronja të shtypit mbiemrin, emrin dhe inicialin e mesëm, nëse keni.

Pastaj shkruani me shkronja shtypi kodin _____ dhe emrin _____ e kësaj shkolle dhe kodin (ose emrin) e kësaj klase testimi _____, të cilin e kam postuar për ju.

Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:

Tani lexoni kopertinën e pasme. Ka informata të rëndësishme për shënjimin e përgjigjeve dhe rezultatit. Kur të përfundoni leximin, ju lutem ngriteni shikimin.

A keni pyetje për atë që sapo lexuat?

Kujdestari juaj do të japë udhëzime shtesë për shënjimin e përgjigjeve duke thënë:

Është e rëndësishme të ndiqni udhëzimet për shënjimin e përgjigjeve në mënyrë që të mund të llogariten pikët në fletën e përgjigjeve tuaja. Do t'i theksoj pikat më të rëndësishme për t'u siguruar se janë të qarta. Ju lutem dëgjoni me kujdes.

- Shënjoni të gjitha përgjigjet tuaja në fletën e përgjigjeve. Mund të përdorni librin tuaj të testit për punë planifikuese, por vetëm përgjigjet e shënuara në fletën e përgjigjeve mund të llogariten përveç nëse keni miratimin e College Board për t'i shënuar ato në librin e testit.

- Pasi të përfundojë koha, nuk mund të transferoni përgjigje nga libri juaj i testit në fletën tuaj të përgjigjeve ose të mbushni flluskat.
- Sigurohuni të përdorni laps Numër 2. Mos përdorni laps kimik, laps me ngjyrë, ose laps mekanik.
- Shënjoni 1 përgjigje për çdo pyetje dhe mbushni plotësisht dhe errësoni flluskat në fletën e përgjigjeve.
- Në fletën e përgjigjeve mos bëni shenja tjera përveç përgjigjeve tuaja. Shenjat tjera në fletën tuaj të përgjigjeve do të ndërhyjnë në rezultat.
- Nëse fshini diçka, fshijeni tërësisht. Fshirjet e paplota mund të llogariten si përgjigje të synuara.

Për studentët të cilat janë miratuar për të regjistruar përgjigjet e tyre në librat e tyre të testimit, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse keni marrë miratimin për t'i shënuar përgjigjet e juaja në librin e testit, rrethoni shkronjën e përgjigjes së zgjedhur në librin e testit. Rrethoni vetëm 1 përgjigje për secilën pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni sa më shumë që mundeni.

Plotëso Informatat e Testit në Fletët e Përgjigjeve

Për fushën 9, Test Type (Lloji i Testit), kujdestari juaj do të thotë:

Në fushën 9, mbushni flluskën për testin të cilit po i nënshtroheni sot, të cilin e kam postuar në tabelë. Ngrini dorën nëse nuk jeni të sigurt për cilin test të mbushni flluskën.

Për fushën A, Form Code (Kodin e Formularit), kujdestari juaj do të thotë:

Gjeni fushën A në pjesën e pasme të fletës suaj të përgjigjeve (ose faqe 16 të fletës suaj të madhe të përgjigjeve). Gjeni Form Code (Kodin e Formularit) në pjesën e pasme të librit tuaj të testit. Në fushën A të fletës suaj të përgjigjeve kopjoni Form Code (Kodin e Formularit) saktësisht siç është i paraqitur në testin tuaj dhe plotësoni flluskat e duhura. Ju lutem ngriteni shikimin lart kur të keni përfunduar.

Për fushën B, Test ID (ID-në e Testit), kujdestari juaj do të thotë:

Për fushën B, gjeni Test ID (ID-në e Testit) në pjesën e pasme të librit tuaj të testit. Kopjoni Test ID (ID-në e Testit) saktësisht siç paraqitet në librin tuaj të testit në fushën B në fletën tuaj të përgjigjeve, dhe mbushni flluskat përkatëse. Ju lutem ngriteni shikimin lart kur të keni përfunduar.

Për fushën C, Test Book Serial Number (Numri Serik i Librit të Testit), kujdestari juaj do të thotë:

Për fushën C, shihni në ballinën e librit tuaj të testit. Gjeni numrin në këndin e epërm të djathtë, të etiketuar Test Book Serial Number (Numri serik i Librit të Testit). Shënoni numrin serik në fushën C në fletën e përgjigjeve dhe mbushni flluskat përkatëse.

Pasi studentët të plotësojnë fushat A–C, kujdestari juaj do të thotë:

Për të parandaluar problemet me marrjen e rezultateve tuaja, kontrolloni fushat për Form Code (Kodin e Formularit), Test ID (ID-në e Testit) dhe Test Book Serial Number (Numri Serik i Librit të Testit) për t'u siguruar se i keni shënuar saktë.

Nëse shkolla juaj përdor kode të klasave testuese, kujdestari juaj do të thotë:

Në fushën D në fletën e përgjigjeve, plotësoni kodin 3 shifror të klasës së testimit, _____, të cilin e kam postuar për ju.

Pikat përfundimtare para testimit

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Testin do ta filloni pas pak minutave, pasi të lexoj edhe disa udhëzime përfundimtare.

Gjatë testimit, mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Nëse gjeni ndonjë gabim në fletën e përgjigjeve ose librin e testit, si p.sh. mungesa e një faqeje, ose nëse kuptoni se keni qenë duke i shkruar përgjigjet në pjesën e gabuar të fletës së përgjigjeve, ngriteni dorën.

Fletët e përgjigjeve dhe librat e testeve nuk duhet të largohen nga klasat e testimit asnjëherë.

Testi është i ndarë në kohë sipas pjesëve. Do të keni pauza gjatë testit kur mund të largoheni nga kjo klasë për të konsumuar zamra ose përdorur tualetin.

Kujdestari juaj do të vazhdojë duke thënë:

Unë do të sillem nëpër klasë kohë pas kohe për t'u siguruar se të gjithë janë duke punuar në pjesën e duhur. Për SAT-in, mund të punoni vetëm në 1 pjesë në të njëjtën kohë. Nuk lejoheni të kaloni në pjesën tjetër derisa të ju thuhet të veproni kështu. Kjo mund të jetë ndryshe ga sa jeni mësuar, kështu që sigurohuni që të mos shkoni para ose të shikoni prapa në pjesë tjetër, edhe nëse e përfundoni pjesën aktuale më herët.

Mbani mend të bëni më të mirën dhe të jepni përgjigje në secilën pyetje, edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë. Nuk o të humbni pikë për përgjigjet e pasakta.

Pasi të përfundojë testi, ju lutem qëndroni ulur dhe mos u largoni nga klasa pa ju lënë të lirë. Nëse keni ndonjë pyetje mund ta bëni tani.

1.4 Udhëzimet në Ballinë



Në vijim është përkthimi i ballinës së librit të testit.

Përkujtues të rëndësishëm

1. Për test kërkohet laps Nr. 2. Mos përdorni laps mekanik ose laps kimik.
2. Ndarja e pyetjeve ose përgjigjeve të testit me këdo është shkelje e Kushteve tona të përgjithshme. Nëse i shkelni Kushtet tona të përgjithshme, mund të anulohet rezultati tuaj dhe t'ua ndalojmë t'i nënshtroheni vlerësimeve në të ardhmen.

KY LIBËR TESTI NUK DUHET TË LARGOHET NGA KLASA. RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR OSE PËRDORIMI I CILËSDO PJESE TË KËTIJ LIBËR TESTI ËSHTË I NDALUAR.

© 2021 College Board. College Board, SAT, dhe logoja e boçës së dushkut janë marka tregtare të regjistruara të College Board.

1.5 Udhëzimet në kopertinën e pasme



Në vijim është përkthimi i ballinës së librit të testit. Kur të udhëzoheni, duhet të shkruani në librin e testit ose në fletën e përgjigjeve, jo në këtë dokument.

EMRI JUAJ

(ME SHKRONJA TË SHTYPIT)

MBIEMRI

EMRI

INICIALI I MESËM

SHKOLLA

KODI I SHKOLLËS

EMRI I SHKOLLËS

KODI / EMRI I KLASËS SË TESTIMIT

SAT

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- Mund të punoni në vetëm një pjesë në të njëjtën kohë.
- Nëse përfundoni një pjesë para përfundimit të kohës, kontrolloni punën tuaj në atë pjesë. MOS kaloni në ndonjë pjesë tjetër.

SHËNJIMI I PËRGJIGJEVE

- Sigurohuni të shënjoni faqen e përgjigjeve si duhet.

Shenja e plotë:



Shenjat jo të plota:



- Duhet të përdorni laps Nr. 2.
- Me kujdes shënjoni vetëm një përgjigje për çdo pyetje.
- Sigurohuni të mbushni tërë fluskën plotësisht dhe ta errësoni.
- Mos bëni ndonjë shenjë rasti në fletën e përgjigjeve.
- Nëse fshini diçka, fshijeni tërësisht. Fshirjet e paplota mund të llogariten si përgjigje të synuara.
- Përdorni vetëm hapësirat e përgjigjeve që përkojnë me numrat e pyetjeve.

PËRDORIMI I LIBRIT TUAJ TË TESTIT

- Mund ta përdorni librin e testit për punë përgatitore, por nuk merrni pikë për asgjë që shkruani në librin e testit.
- Pasi të përfundojë koha, nuk mund të transferoni përgjigje nga libri juaj i testit në fletën tuaj të përgjigjeve ose të mbushni fluskat.
- Nuk duhet të palosni apo largoni faqe apo pjesë të faqeve nga ky libër, ose të merrni librin apo fletën e përgjigjeve nga klasa e testimit.

FITIMI I PIKËVE

- Për çdo përgjigje të saktë do të merrni një pikë.
- Nuk humbni pikë për përgjigje të gabuara; prandaj, duhet të përpiqeni të përgjigjeni në secilën pyetje edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë.

Idetë që përmbajnë pasazhet për këtë test, disa nga të cilat janë nxjerrë ose përshtatur nga materialet e publikuara, nuk i paraqesin domosdo mendimet e College Board.

ME RËNDËSI

Kodet e mëposhtme janë unike për librin e testit tuaj. Kopjoni ato në fletën tuaj të përgjigjeve në fushat A dhe B dhe mbushni fluskat përkatëse saktësisht siç tregohen.

A Form Code									
A	A	A	A	0	0	0			
B	B	B	B	1	1	1			
C	C	C	C	2	2	2			
D	D	D	D	3	3	3			
E	E	E	E	4	4	4			
F	F	F	F	5	5	5			
G	G	G	G	6	6	6			
H	H	H	H	7	7	7			
I	I	I	I	8	8	8			
J	J	J	J	9	9	9			
K	K	K	K						
L	L	L	L						
M	M	M	M						
N	N	N	N						
O	O	O	O						
P	P	P	P						
Q	Q	Q	Q						
R	R	R	R						
S	S	S	S						
T	T	T	T						
U	U	U	U						
V	V	V	V						
W	W	W	W						
X	X	X	X						
Y	Y	Y	Y						
Z	Z	Z	Z						

B Test ID									
0	0	0	0	0	0	0			
1	1	1	1	1	1	1			
2	2	2	2	2	2	2			
3	3	3	3	3	3	3			
4	4	4	4	4	4	4			
5	5	5	5	5	5	5			
6	6	6	6	6	6	6			
7	7	7	7	7	7	7			
8	8	8	8	8	8	8			
9	9	9	9	9	9	9			

MOS E HAPNI KËTË LIBËR DERISA KUJDESTARI TË JU THOTË TA BËNI KËTË.

2 Skripta standarde për Klasa të Pakombinuara

2.1 Pjesa 1: Testi i leximit



Koha standarde për Pjesën 1 është **65 minuta**, me një pushim prej **5-minuta** në fund të pjesës. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të fillojmë testimin me Pjesën 1, Testi i Leximit. Pasi të fillojmë, do të keni 65 minuta për të punuar në Pjesën 1. Do të kemi një pushim të shkurtër pasi të përfundojë pjesa. Do të postoj kohët e nisjes dhe ndaljes, dhe do të ju njoftoj kur të jemi afër mesit të Pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta.

Ju lutem hapni fletën e përgjigjeve të Pjesa 1. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 1 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër. Nëse e kaloni një pyetje për t'iu kthyer më vonë, sigurohuni të lini atë vijë të zbraztë në fletën e përgjigjeve. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur.

Nëse përfundoni para se të them se koha mbaroi, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit. Ju nuk humbni pikë për përgjigje të pasakta, kështu që përpiquni të përgjigjeni në secilën pyetje edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë.

Tani, hapni librin tuaj të testit në Pjesën 1. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Fat të mbarë, të gjithë.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.1 Gjatë Pjesës

Pas 30 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 35 minuta të mbetur në Pjesën 1.

Pas 60 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 1.

Pas saktësisht 65 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.1 Pjesa 1 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 1 të librit të testit.

65 MINUTA, 52 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 1 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.

UDHËZIMET

Çdo pasazh ose çift pasazhesh më poshtë pasohet nga një numër pyetjesh. Pas leximit të çdo pasazhi apo çifti pasazhesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për secilën pyetje duke u bazuar në çfarë është deklaruar apo nënkuptuar në pasazhin ose pasazhet dhe në ndonjë grafikë shoqëruese (siç janë tabelat apo diagramet).

2.1 Pas Pjesës 1

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni fletën e përgjigjeve në faqen e librit të testit ku keni ndalur punën. Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

Për pauzë, kujdestari juaj do të thotë:

Do të ndalemi për një pushim prej 10-minuta. Ju lutem dëgjoni me kujdes këto rregulla:

- Mos diskutoni pyetjet e testit me askënd ose mos përdorni asnjë lloj të pajisjeve elektronike gjatë këtij puhimi ose cilitdo pushimi tjetër gjatë testit.
- Nëse keni nevojë të largoheni nga klasa, shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, në korridor ose në banjo.
- Zamrat dhe pijet lejohen vetëm në zonat e destinuara.
- Ju lutem kini konsideratë për studentët që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht minutave.10

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

2.2 Deklarata e vërtetimit

Kur të gjithë studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:

Kur dorëzoni fletën e përgjigjeve pajtoheni se në çfarëdo rrethana nuk do të merrni jashtë dhomës së testimit asnjë pyetje të testit, t'ia jepni ato ndokujt, apo t'i diskutoni ato me ndokënd përmes çfarëdo mjeti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, postë elektronike, mesazhe tekstuale, ose internetit. Këto kushte ekzistojnë për t'u siguruar që të gjithë studentët të kenë një përvojë të drejtë dhe të barabartë. Këto kushte janë të shkruara në *SAT School Day Student Guide* e qasshme për të gjithë testuesit e SAT School Day dhe online në sat.org.

Nxirreni fletën e përgjigjeve por lëreni të mbyllur librin e testit. Dilni në pjesën e pasme të fletës së përgjigjeve dhe gjeni fushën e Certification Statement (Deklaratës së Vërtetimit). Pas leximit të paragrafit të kushteve në fund, kopjoni

deklaratën me stilin e zakonshëm të dorëshkrimit tuaj—bën edhe me shkronja shtypi ose stil kursiv. Pastaj nënshkruani emrin e plotë siç do ta bënit në një dokument zyrtar. Pranë nënshkrimit, shënoni datën e sotme. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Në vijim është përkthimi i Deklaratës Vërtetuese në anën e pasme të fletës së përgjigjeve. Kopjoni deklaratën në anglisht, jo përkthimin e dhënë këtu.

Vërtetohet se jam personi i listuar në fletën e përgjigjeve zotohem të respektoj kushtet e përgjithshme të SAT në *SAT School Day Student Guide*.

2.3 Pjesa 2: Testi i Shkrimit dhe Gjuhës



Koha standarde për Pjesën 2 është **35 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me Pjesën 2, Testi i Shkrimit dhe Gjuhës. Pasi të fillojmë, do të keni 35 minuta për të punuar në Pjesën 2. Do të postoj kohën e fillimit dhe ndaljes, dhe do të ju njoftoj kur jemi kah mesi i pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta.

Gjeni Pjesën 2 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 2 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.

Nëse përfundoni para se të them se koha mbaroi, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në Pjesën 2. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.3 Gjatë Pjesës

Pas 15 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 20 minuta të mbetur në Pjesën 2.

Pas 30 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 2.

Pas saktësisht 35 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.3 Pjesa 2 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 2 të librit të testit.

35 MINUTA, 44 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 2 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur në pyetjet e kësaj pjesë.

UDHËZIMET

Çdo pasazh më poshtë është i shoqëruar me një numër të pyetjeve. Për disa pyetje, do të konsideroni se si pasazhi do të mund të revidohej për të përmirësuar shprehjen e ideve. Për pyetjet tjera, do të konsideroni se si mund të redaktohet pasazhi për të korrigjuar gabimet në strukturën e fjalisë, përdorimin dhe shenjat e pikësimit. Një pasazh ose një pyetje mund të shoqërohet me një ose më shumë grafika (siç janë tabelat apo diagramet) që do ti konsideroni ndërsa merrni vendime për revidim dhe redaktim.

Disa pyetje do t'ju drejtojnë te një pjesë e nënvizuar e një pasazhi. Pyetje të tjera do t'ju drejtojnë te një vend në një pasazh ose do t'u kërkojnë të mendoni për pasazhin si tërësi.

Pas leximit të çdo pasazhi, zgjidhni përgjigjen për çdo pyetje që në mënyrën më efektive e përmirëson cilësinë e shkrimit në pasazh ose që e bën pasazhin të jetë në përputhje me konventat e anglishtes standarde të shkruar. Shumë pyetje e përfshijnë opsionin „NO CHANGE“ („NUK KA NDRYSHIM“). Zgjidhni atë opsion nëse mendoni se zgjidhja më e mirë është të lihet pjesa përkatëse e pasazhit ashtu si është.

2.3 Pas Pjesës 2

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni fletën e përgjigjeve në faqen e librit të testit ku keni ndalur punën.
Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

2.4 Pjesa 3: Testi i Matematikës – Pa Kalkulator



Koha standarde për Pjesën 3 është **25 minuta**, me një pushim prej **5-minuta** në fund të pjesës. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me Pjesën 3, Testi i Matematikës pa Kalkulator. Pasi të fillojmë, do të keni 25 minuta për të punuar në Pjesën 3. Do të kemi një pushim të shkurtër pasi të përfundojë pjesa. Do të postoj kohët e nisjes dhe ndaljes, dhe do të ju njoftojë kur të jemi afër mesit të Pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta.

Kujdestari juaj do të thotë:

Gjeni Pjesën 3 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjonit përgjigjet tuaja në Pjesën 3 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.

Shumica e pyetjeve janë me zgjedhje të një përgjigjeje nga shumë të dhëna, por disa pyetje janë me përgjigje të prodhuara nga studentët. Udhëzimet për plotësimin e përgjigjeve tuaja në këto pyetje janë në librin e testit. Asnjëherë nuk do të ju nevojiten më shumë se 4 hapësira për të regjistruar përgjigjen tuaj, edhe pse disa përgjigje mund të mos përdorin të 4 hapësirat.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Edhe pse kjo është pjesa e matematikës, nuk ju lejohet të përdorni kalkulator në këtë pjesë të testit. Ju lutemi mbani kalkulatorin tuaj nën tavolinë përveç nëse jeni miratuar për të përdorur kalkulator 4 funksionësh si akomodim.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në Pjesën 3. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.4 Gjatë Pjesës

Pas 10 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 15 minuta të mbetur në Pjesën 3.

Pas 20 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 3.

Pas saktësisht 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.4 Pjesa 3 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 3 të librit të testit.

25 MINUTA, 20 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 3 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur në pyetjet e kësaj pjese.


UDHËZIMET

Për pyetjet 1-15, zgjidhni secilin problem, zgjedhni përgjigjen më të mirë nga opsionet e dhëna, dhe plotësoni fluskën korresponduese në fletën tuaj të përgjigjeve. Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelën në fletën e përgjigjeve. Ju lutemi referojuni udhëzimeve para pyetjes 16 se si të shënoni përgjigjen tuaj në tabelë. Mund të përdorni cilëndo hapësirë të disponueshme në broshurën e testit për punë përgatitore.


SHËNIME

1. Përdorimi i kalkulatorit **nuk lejohe**t.
2. Të gjitha variablat dhe shprehjet e përdorura paraqesin numra real përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë test janë të vizatuara në shkallë të zvogëluar përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat shtrihen në rrafsh përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave real x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = l w$$





$$A = \frac{1}{2} b h$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndëshat e drejtë të veçantë




$$V = l w h$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3} \pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3} \pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3} l w h$$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

UDHËZIMET

Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelë, siç përshkruhet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

1. Edhe pse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në mbi kolona për të ju ndihmuar t'i mbushni saktë flluskat. Do të merrni pikë vetëm nëse flluskat janë të mbushura si duhet.
2. Mos shënjeni më shumë se një flluskë në cilëndo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të duhur. Në raste të tilla, në rrjet shënoni vetëm një përgjigje.
5. Numrat e përzier si $3\frac{1}{2}$ duhet të shënohen në rrjet si 3.5 ose $7/2$. (Nëse $\frac{3\frac{1}{2}}{2}$ shënohet në rrjet, do të interpretohet si $31/2$, not $3\frac{1}{2}$.)
6. **Përgjigjet decimale:** Nëse merrni një përgjigje decimale me më shumë shifra se sa që mund të akomodojë rrjeti, mund të rumbullakësohet ose prehet, por duhet ta mbush tërë rrjetin.

Përgjigja: $\frac{7}{12}$		Përgjigja: 2,5	
Shkruani përgjigjen në kuti.	7 / 1 2		2 . 5
	<input type="radio"/> <input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/>
	0 0 0	0 0 0	0 0 0
	1 1 1	1 1 1	1 1 1
	2 2 2	2 2 2	2 2 2
	3 3 3	3 3 3	3 3 3
	4 4 4	4 4 4	4 4 4
	5 5 5	5 5 5	5 5 5
	6 6 6	6 6 6	6 6 6
	7 7 7	7 7 7	7 7 7
	8 8 8	8 8 8	8 8 8
	9 9 9	9 9 9	9 9 9
Rezultati në rrjet.			

Mënyrat e pranueshme për të lidhur $\frac{2}{3}$ janë:

2 / 3		. 6 6 6		. 6 6 7	
<input type="radio"/> <input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>
0 0 0	0 0 0	0 0 0	0 0 0	0 0 0	0 0 0
1 1 1	1 1 1	1 1 1	1 1 1	1 1 1	1 1 1
2 2 2	2 2 2	2 2 2	2 2 2	2 2 2	2 2 2
3 3 3	3 3 3	3 3 3	3 3 3	3 3 3	3 3 3
4 4 4	4 4 4	4 4 4	4 4 4	4 4 4	4 4 4
5 5 5	5 5 5	5 5 5	5 5 5	5 5 5	5 5 5
6 6 6	6 6 6	6 6 6	6 6 6	6 6 6	6 6 6
7 7 7	7 7 7	7 7 7	7 7 7	7 7 7	7 7 7
8 8 8	8 8 8	8 8 8	8 8 8	8 8 8	8 8 8
9 9 9	9 9 9	9 9 9	9 9 9	9 9 9	9 9 9

Përgjigja: 201 – cilado pozitë është e saktë

2 0 1		2 0 1	
<input type="radio"/> <input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input checked="" type="radio"/> <input type="radio"/>	<input type="radio"/> <input type="radio"/> <input type="radio"/>
0 0 0	0 0 0	0 0 0	0 0 0
1 1 1	1 1 1	1 1 1	1 1 1
2 2 2	2 2 2	2 2 2	2 2 2
3 3 3	3 3 3	3 3 3	3 3 3
4 4 4	4 4 4	4 4 4	4 4 4

SHËNIM:
Përgjigjet e juaja mun t'i filloni në cilindo kolonë, nëse e lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet lënë të zbrazëta

2.4 Pas Pjesës 3

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni fletën e përgjigjeve në faqen e librit të testit ku keni ndalur punën. Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

Për pauzë, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ndalemi për një pushim të shkurtë. Për pushim, nëse keni sjellë zamra, mund ta hani vetëm në zonat e dedikuara. Sikurse më parë, nëse ju duhet të largoheni nga klasa, mos shkoni askund tjetër përveç në hapësirat e dedikuara, në korridor, ose në banjo. Mos flisni në korridor, mos diskutoni pyetjet e testit me askënd, ose mos përdorni asnjë lloj të pajisjeve elektronike gjatë pauzës.

Do të fillojmë testimin sërish pas saktësisht 5 minutave.

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

2.5 Pjesa 4: Testi i Matematikës – Kalkulator



Koha standarde për Pjesën 4 është **55 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me Pjesën 4, Testi i Matematikës me Kalkulator. Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta për të punuar në Pjesën 4. Do t'i postoj kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit, dhe do t'ju njoftoj kur të kalojë gjysma e kohës së pjesës dhe kur të mbeten edhe minuta.5

Kujdestari juaj do të thotë:

Për këtë pjesë mund të përdorni kalkulator. Nëse keni kalkulator, ju lutem largoni mbulesën dhe vendoseni kalkulatorin në tavolinën tuaj tani. Mbani mbulesën e kalkulatorit në dysheme nën tavolinën tuaj gjatë testimit.

Edhe pse ju lejohet të përdorni kalkulator për këtë pjesë, mund të jepet përgjigje në të gjitha pyetjet pa kalkulator. Nëse përdorni kalkulator, mbani mend të ndiqni këto udhëzime:

- Mbani kalkulatorin rrafsh në tavolinën tuaj ose mbajeni ashtu që studentët tjerë të mos mund të shohin punën tuaj.
- Mos e ndani apo shkëmbeni kalkulatorin tuaj.
- Nëse keni kalkulator rezervë apo bateri, mbani në dysheme në tavolinën tuaj.
- Nëse kalkulatori juaj nuk funksionin dhe keni bateri ose kalkulator rezervë, ngriteni dorën. Do të afrohem për të ju ndihmuar. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni testin dhe bëni më të mirën që mundeni.

Gjeni Pjesën 4 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 4 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.

Shumica e pyetjeve janë me zgjedhje të një përgjigjeje nga shumë të dhëna, por disa pyetje janë me përgjigje të prodhuara nga studentët. Plotësoni këtë njëjtë siç keni bërë me pjesën e kaluar.

Kujdestari juaj do të thotë:

Nëse përfundoni para se të them se koha mbaroi, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në 4. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.5 **Gjatë Pjesës**

Pas 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 30 minuta të mbetur në Pjesën 4.

Pas 50 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 4.

Pas saktësisht 55 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.5 Pjesa 4 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 4 të librit të testit.

55 MINUTA, 38 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 4 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur në pyetjet e kësaj pjese.


UDHËZIMET

Për pyetjet 1-30, zgjidhni secilin problem, zgjedhni përgjigjen më të mirë nga opsionet e dhëna, dhe plotësoni fluskën korresponduese në fletën tuaj të përgjigjeve. **Për pyetjet 31-38**, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelën në fletën e përgjigjeve. Ju lutemi referojuni udhëzimeve para pyetjes 31 se si të shënoni përgjigjen tuaj në tabelë. Mund të përdorni cilëndo hapësirë të disponueshme në broshurën e testit për punë përgatitore.

SHËNIME

1. Përdorimi i kalkulatorit **lejohet**.
2. Të gjitha variablat dhe shprehjet e përdorura paraqesin numra real përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë test janë të vizatuara në shkallë të zvogëluar përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat shtrihen në rrafsh përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave real x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = l w$$





$$A = \frac{1}{2} b h$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndëshat e drejtë
të veçantë




$$V = l w h$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3} \pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3} \pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3} l w h$$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

UDHËZIMET

Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelë, siç përshkruhet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

1. Edhe pse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në mbi kolona për të ju ndihmuar t'i mbushni saktë flluskat. Do të merrni pikë vetëm nëse flluskat janë të mbushura si duhet.
2. Mos shënjoni më shumë se një flluskë në cilëndo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të duhur. Në raste të tilla, në rrjet shënoni vetëm një përgjigje.
5. Numrat e përzier si $3\frac{1}{2}$ duhet të shënohen në rrjet si 3.5 ose $7/2$. (Nëse $\frac{3\frac{1}{2}}{2}$ shënohet në rrjet, do të interpretohet si $31/2$, not $3\frac{1}{2}$.)
6. Përgjigjet decimale: Nëse merrni një përgjigje decimale me më shumë shifra se sa që mund të akomodojë rrjeti, mund të rumbullakësohet ose prehet, por duhet ta mbush tërë rrjetin.

Përgjigja: $\frac{7}{12}$ Përgjigja: 2,5

Shkruani përgjigjen në kuti.	7	/	1	2	Vizë thyese	2	.	5	Pikë decimale
	○	○	○	○		○	○	○	
Rezultati në rrjet.	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1	1	1	1	1	1	1	1	1
	2	2	2	2	2	2	2	2	2
	3	3	3	3	3	3	3	3	3
	4	4	4	4	4	4	4	4	4
	5	5	5	5	5	5	5	5	5
	6	6	6	6	6	6	6	6	6
	7	7	7	7	7	7	7	7	7
	8	8	8	8	8	8	8	8	8
	9	9	9	9	9	9	9	9	9

Mënyrat e pranueshme për të lidhur $\frac{2}{3}$ janë:

2	/	3					
○	○	○	○	○	○	○	○
0	0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9

.	6	6	6				
○	○	○	○	○	○	○	○
0	0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9

.	6	6	7				
○	○	○	○	○	○	○	○
0	0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9

Përgjigja: 201 – cilado pozitë është e saktë

2	0	1			
○	○	○	○	○	○
0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4

2	0	1			
○	○	○	○	○	○
0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4

SHËNIM:
Përgjigjet e juaja mun t'i filloni në cilindo kolonë, nëse e lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet lënë të zbrazëta

2.5 Pas Pjesës 4

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Mbyllni fletën e përgjigjeve ashtu që faqja 1 të jetë më së larti. Mbylleni librin tuaj të testit.

Tani kujdestari juaj do të thotë:

Para se të mbledh materialet tuaja të testit, ju lutem kthejeni përmbys fletën tuaj të përgjigjeve (ose dilni në faqen 16 nëse jeni duke përdorur fletën e madhe të përgjigjeve) dhe kontrolloni a keni plotësuar Form Code (Kodin e formularit) në fushën A. Ky Form Code (Kod i formularit) kërkohet për rezultatin e testit tuaj.

Kontrolloni gjithashtu a i keni kompletuar fushat B dhe C. Ju lutem ngriteni dorën nëse keni nevojë për ndihmë në plotësimin e cilësdo fushë.

Për studentët që janë duke u testuar në SAT pa Ese

Testimi ka përfunduar. Vazhdoni tutje te [Kur të mbarojë testimi](#) ne faqe 24

Për studentët që janë duke u testuar në SAT, me Ese

Kujdestari juaj do të vazhdojë me pushimin që pason.

2.5 Pauza mes pjesëve

Pas grumbullimit dhe numërimit të librave të testit kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni kalkulatorin nën tavolinë. Tani do të bëjmë një pauzë prej 2 minutave zgjatje. Nuk duhet të largoheni nga klasa ose diskutoni pyetjet e testit.

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj.

2.6 Eseja



Koha standarde për Pjesën Eseja është **50 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ju jap nga një libër të Esesë secilit prej juve. Mos e hapni librin e Esesë deri të mos ju them ta bëni këtë.

Kujdestari juaj do të vazhdojë duke thënë:

Kur të merrni librin e Esesë kthejeni përmbys dhe shkruani me shkronja të shtypit mbiemrin, emrin dhe inicialin e mesëm, nëse keni. Pastaj shkruani me shkronja shtypi kodin _____ dhe emrin _____ e kësaj shkolle dhe kodin (ose emrin) e kësaj klase testimi _____, të cilin e kam postuar për ju.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem hapni fletën e përgjigjeve te Pjesa 6. Nëse jeni duke përdorur një fletë të përgjigjeve të madhe, hapeni në faqen 30. Në anën e prapme të Librit të Esesë gjeni Essay Code (Kodin e Esesë). Kopjoni Essay Code (Kodin e Esesë) në fushën e fletës së përgjigjeve saktësisht siç paraqitet në anën e pasme të librit të Esesë dhe mbushni flluskën përkatëse. Kjo fushë duhet të plotësohet si duhet, ose eseja juaj mund të mos vlerësohet me pikë.

Kur të gjithë studentët të kenë një libër Eseje, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ju jap disa udhëzime për të ju ndihmuar të siguroheni se eseja juaj do të vlerësohet saktë.

- Përdorni faqen planifikuese pa vija për të marrë shënime dhe planifikuar esenë tuaj. Asgjë që shkruani në faqen pa vija nuk do të vlerësohet për pikë.
- Kur të jeni gati, filloni të shkruani esenë tuaj në faqen e parë me vija, që thotë „Begin Your Essay Here” („Filloni Esenë Tuaj Këtu“). Shkruani esenë tuaj në këto faqe me vija dhe brenda margjinave të shënuara.
- Përdorni laps Numër 2. Nëse nuk përdorni laps, ose nëse i leni faqet e zbrazëta, do të vlerësoheni me zero pikë në Ese.
- Eseja juaj duhet të përshtatet për ta zënë faqet e ofruara. Mos shkruani asgjë përtej fjalës “STOP” në faqen e fundit me vija, sepse çfarëdo e shkruar pas kësaj pike nuk do të vlerësohet për pikë.

Për të filluar Esenë, kujdestari i juaj do të thotë:

Tani do të kalojmë te Eseja. Pasi të fillojmë, do të keni 50 minuta për të punuar në pjesën e Esesë. Do të postoj kohët e nisjes dhe ndaljes, dhe do të ju njoftojë kur të jemi afër mesit të Pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta. Mbani fletën tuaj të përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë.

Ju lutem mos e nënshkruani esenë tuaj ose mos shtoni emrin tuaj në të (si në „By Jane Doe“). Nëse e bëni këtë, kjo mund të vonojë rezultatin e esesë suaj.

Tani lexoni udhëzimet, pastaj kaloni te pyetja për Ese dhe filloni punën. Koha fillon tani.

2.6 Gjatë Esesë

Pas 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 25 minuta në pjesën e Esesë.

Pas 45 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në pjesën e Esesë.

Pas saktësisht 50 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë. Mbyllni fletën e përgjigjeve dhe librin e Esesë. Vendosni fletën e përgjigjeve me ballinën lart pranë librit të Esesë.

2.6 Udhëzimet e Librit të Esesë



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në pjesën e përparme të librit të Esesë.

UDHËZIMET

Eseja ju jep një mundësi për të treguar se sa në mënyrë efektive mund të lexoni dhe kuptoni një pasazh dhe të shkruani një ese duke analizuar pasazhin. Në esenë tuaj, duhet të demonstroi se e keni lexuar pasazhin me kujdes, të paraqitni një analizë të qartë dhe logjike dhe të përdorni gjuhën në mënyrë precize.

Eseja duhet të shkruhet në vijat e dhëna në fletën tuaj të përgjigjeve; përveç Faqes së Planifikimit të fletëve të përgjigjeve, nuk do të merrni letër tjetër për të shkruar në të. Do të keni hapësirë të mjaftueshme nëse shkruani në çdo vijë, shmangni margjinat e gjera dhe shkruani me dorë me një madhësi të arsyeshme. Mbani mend se atë që do të shkruani do ta lexojnë njerëz që nuk janë të mësuar me dorëshkrimin tuaj. Mundohuni të shkruani dhe të shtypni ashtu që të jenë të lexueshme për këta lexues.

PËRKUJTUES

- Mos e shkruani esenë tuaj në këtë broshurë. Vetëm ato që i shkruani në faqet me vija të fletëve tuaja të përgjigjeve do të vlerësohen.
- Eseja jashtë teme nuk do të vlerësohet

Keni 50 minuta (kohë standarde) për të lexuar pasazhin dhe shkruar një ese në përgjigje të udhëzimeve të dhëna brenda kësaj broshure.

KY LIBËR TESTI NUK DUHET TË LARGOHET NGA KLASA. RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR OSE PËRDORIMI I CILËSDO PJESE TË KËTIJ LIBËR TESTI ËSHTË I NDALUAR.

2.6 Pas Esesë

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem qëndroni ulur të qetë ndërsa i grumbulloj librat e Esesë.

2.6 Kur të mbarojë testimi

Studentët të cilët kanë përfunduar testimin mund të jetë e nevojshme të lirohen në 2 grupe—studentët të cilët kanë plotësuar të gjitha fushat në fletën e përgjigjeve (që duhet të lirohen të parët), dhe studentët që nuk kanë plotësuar informatat që nuk janë test në fletët e tyre të përgjigjeve ose që duan të bëjnë ndryshime në raportet e tyre të rezultateve në fushën 15 të fletës së përgjigjeve.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Urime, keni përfunduar testin.

Tani dëgjoni këto informata të rëndësishme. Nëse doni të anuloni rezultatin tuaj para se të largoheni, ma kërkoni një formular të Request to Cancel Test Scores (Kërkesës për Anulim të Rezultatit të Testit), të cilin duhet ta plotësoni para se të largoheni nga klasa. Për të anuluar rezultatet e juaja më vonë, duhet ta njoftoni College Board-in me shkrim.

Nuk mund të anuloni rezultatin tuaj me një mesazh përmes postës elektronike ose një telefonate. Dërgoni kërkesën për anulim të nënshkruar përmes postës brenda natës ose faksit, jo më vonë se ora 23:59 e Kohës Lindore në ditën e katërt të javës nga sot. Formularin mund ta gjeni edhe në internet në sat.org.

Nëse anuloni rezultatet tuaja, ato prapëseprapë do t'i dërgohen shtetit, por nuk do të dërgohen në kolegjet ose organizatat e bursave të zgjedhura nga ju e as të jenë në dispozicion në sistemin e raportimit të College Board.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse ende keni informata që nuk janë të testit për t'i plotësuar në fletën tuaj të përgjigjeve, përfshirë çfarëdo ndryshimi që dëshironi të bëni në fushën 15, ku mund të zgjedhni cilat kolegje ose programe të bursave dëshironi që të pranojnë rezultatet tuaja, ju lutem hapni fletën tuaj të përgjigjeve në faqen 2. Kërkesat për raport të rezultateve që i bëni tani do të jenë pa pagesë. Qëndroni ulur në qetësi dhe mos shkruani në fletën e përgjigjeve ndërsa i liron studentët tjerë. Për pak minuta do të ju ndihmoj të plotësoni fletën tuaj të përgjigjeve.

Për studentët që kanë plotësuar infirmatat që nuk janë të testit në fletët e përgjigjeve, vazhdoni në [Grumbullimi i Fletëve të Përgjigjeve](#) në faqe 27.

2.6 Plotësimi i Fletës së Përgjigjeve

Nëse i keni plotësuar informatat personale në fletën tuaj të përgjigjeve, mbani fletën e përgjigjeve të mbyllur. Kujdestari juaj do të mbledhë fletët tuaja të përgjigjeve. Përndryshe, qëndroni ulur në qetësi ndërsa studentët tjerë lirohen.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Ndiqueni broshurën *Student Answer Sheet Instructions* ndërsa i lexoj udhëzimet për ju.

Për fushat 10–14, kujdestari juaj do të thotë:

Kaloni në faqen 2 dhe shënioni adresën tuaj në fushat 10 deri 13 të fletës suaj të përgjigjeve. Këto fusha janë opsionale por rekomandohen. Lini fushën 14 të zbraztë. Ngriteni dorën nëse keni ndonjë pyetje. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Për fushën 15, kujdestari juaj do të thotë:

Gjeni fushën 15 në faqen 2 të fletës suaj të përgjigjeve. Kur i nënshtroheni SAT-it si pjesë e SAT School Day, keni të drejtë t'ua dërgoni rezultatet e juaja deri 4 kolegjeve ose programeve të bursave. Nëse e plotësoni këtë pjesë opsionale, rezultatet tuaja do të dërgohen pa pagesë. Rezultatet mund t'i dërgoni edhe më vonë për një taksë të vogël. Kolegjet dhe universitetet janë gjithnjë të interesuara të marrin rezultatet e studentëve, edhe nëse jeni gati të aplikoni.

Gjeni Listën e Kodeve të Raportimit të Rezultatit në broshurën *Student Answer Sheet Instructions* tuaj. Përdorni këtë listë për të gjetur numrin 4 shifror për shkollat ose programet e bursave të cilave doni t'ua dërgoni rezultatet tuaja. Kolegjet dhe universitetet e SHBA-ve janë të listuara së pari në radhë alfabetike sipas shtetit. Pastaj vijojnë institucionet në territoret e SHBA-ve, të pasuara nga ato ndërkombëtare. Lista e fundit në këtë broshurë tregon programet e bursave të listuara sipas shteteve ose vendeve, në radhë alfabetike.

Për çdo që doni të dërgoni rezultatet, kopjoni 4 shifrat në kuti dhe mbushni flluskat përkatëse. Më njoftoni nëse keni ndonjë pyetje.

Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Tani kujdestari juaj do të thotë:

Nëse nuk keni informata tjera për të përfshirë në fletën tuaj të përgjigjeve, mbyllni *Student Answer Sheet Instructions* dhe fletën tuaj të përgjigjeve, dhe vendosni fletën e përgjigjeve me ballinë lart në tavolinën tuaj.

Nëse tashmë i keni plotësuar fushat 16–39 në fletën tuaj të përgjigjeve, kaloni në Answer Sheet Collection dhe prisni derisa kujdestari juaj i lexon skriptat e radhës për studentët tjerë.

Për studentët që mbeten në klasë, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do t'u ndihmojë studentëve të fillojnë të plotësojnë pjesën e mbetur të fletës së përgjigjeve dhe ndërsa ata janë duke punuar do t'i liroj të gjithë ata që kanë përfunduar.

Për fushën 16, kujdestari juaj do të thotë:

Kaloni në faqen 3. Ndiqni udhëzimet në broshurën tuaj për të plotësuar fushën 16 dhe tregoni nëse doni të vendosni ose jo. Ngriteni dorën nëse keni pyetje.

Për fushën 17, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse doni të merrni informata nga College Board përmes postës elektronike, përfshirë informata për rezultatin tuaj pasi të jenë të disponueshme online, shkruani adresën tuaj të emailit dhe mbushni flluskat përkatëse në fushën 17. Kjo është në faqen 6 nëse jeni duke përdorur fletë të madhe të përgjigjeve. Tregoni në pjesën e sipërme të fushës nëse kjo është adresa juaj apo e prindit a kujdestarit ligjor. Nëse jepni email adresën tuaj dhe keni përzgjedhur Student Search Service (Shërbimin e Kërkimit për Studentë) në fushën 16, mund të merrni edhe informata nga kolegjet që dërgohen te ju.

Për të gjithë studentët, për fushën 18, kujdestari juaj do të thotë:

Fusha 18 kërkon numrin mobil tuajin në SHBA. Vetëm numrat e mobilëve në SHBA pranohen. Kjo fushë është opsionale. Nëse pajtoheni me kushtet e shtypura në fletën tuaj të përgjigjeve, shënoni numrin tuaj të telefonit. Ju lutemi, kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të plotësojmë pjesën e mbetur të pyetjeve që nuk janë test, në të cilat kërkohen më shumë informata rreth juve, përvojat paraprake të shkollimit, si dhe aktivitetet dhe interesat.

Mund të lexoni për përfitimet nga dhënia e këtij informacioni opsional në broshurën *Student Answer Sheet Instructions* tuaj. Është e rëndësishme që ta dini se College Board do të mund të përdorë këto informata dhe t'ia ofrojë ato të tjerëve për përdorime shtesë siç janë hulumtimet.

Këto fusha janë opsionale. Nëse prindi juaj ose kujdestari ligjor ju kanë thënë se nuk duhet të plotësoni asnjë informatë opsionale ose vullnetare, ju lutem qëndroni ulur në qetësi derisa e kalojmë këtë aktivitet. Mos plotësoni asnjë fushë që kërkon informata që prindi juaj apo kujdestari ligjor ju kanë thënë të mos i jepni.

Udhëzimet se si të plotësohen këto fusha janë dhënë në broshurën *Student Answer Sheet Instructions* tuaj duke filluar nga faqja 2. Ndiqni udhëzimet për të plotësuar fushat 19 deri 22. Pastaj kaloni në pjesën e brendshme të kopertinës së prapme të fletës suaj të përgjigjeve (ose faqe 8 në fletën tuaj të madhe të përgjigjeve) për të plotësuar fushat 23 deri 39. Ngriteni dorën nëse keni ndonjë pyetje.

Kur të përfundoni, mbyllni broshurën *Student Answer Sheet Instructions* dhe vendoseni pranë fletës tuaj të përgjigjeve në tavolinën tuaj. Vendoseni fletën e përgjigjeve me ballinë lartë në tavolinën tuaj. Ju lutem prisni në qetësi ndërsa të tjerët përfundojnë.

2.6 Grumbullimi i Fletëve të Përgjigjeve

Për studentët që janë gati të lirohen, kujdestari juaj do të thotë:

Mbani mend, në çfarëdo rrethana nuk do të merrni jashtë dhomës së testimit asnjë pyetje të testit, t'ia jepni ato ndokujt, apo t'i diskutoni ato me ndokënd përmes çfarëdo mjeti, duke përfshirë, postës elektronike, mesazheve tekstuale, ose internetit.

Për studentët që kanë përfunduar Esenë SAT, kujdestari juaj do të thotë:

Përveç kësaj, nuk lejoheni ta diskutoni apo ndani pyetjen e Esesë së sotme deri pasi të shpallen rezultatet.

Kujdestari juaj do t'ua përkujtojë studentëve pasojat duke thënë:

Siç kam thënë në fillim të testit, nëse një person shkel cilëndo nga këto politika që kanë të bëjnë me sigurinë e testit, rezultatet e tyre do të zhvlerësohen dhe atyre mund t'u ndalohet pjesëmarrja në testet tjera të College Board në të ardhmen.

(A) Nëse studentët kanë nevojë të mbledhin gjërat e tyre personale, kujdestari juaj do të thotë:

Ky administrim i testit tani ka përfunduar. Ndërsa përgatiteni të largoheni, ju lutem afroheni dhe merrni gjërat e juaja personale të cilat i kam mbledhur nga ju më herët. Pasi të keni marrë të gjitha gjërat tuaja, mund të dilni nga klasa në qetësi. Ju lutem, mbani në mend se studentët në klasat tjera mund të jenë ende duke u testuar. Urime edhe njëherë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe për gjithë punën tuaj.

(B) Nëse studentët kanë të gjitha gjërat e tyre personale, kujdestari juaj do të thotë:

Administrimi i testit tani ka përfunduar. Mblidhni gjërat e juaja dhe dilni nga klasa me qetësi. Ju lutem, mbani në mend se studentët në klasat tjera mund të jenë ende duke u testuar. Urime edhe njëherë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe për gjithë punën tuaj.

Nëse disa studentë janë duke përitur për të plotësuar informatat opsionale që nuk janë test në fletët e tyre të përgjigjeve, ata do të kthehen në [Plotësimi i Fletës së Përgjigjeve](#) ne faqe 25.

3 Skripa standarde për Klasa të Kombinuara

3.1 Pjesa 1: Testi i leximit



Koha standarde për Pjesën 1 është **65 minuta**, me një pushim prej **5-minuta** në fund të pjesës. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të fillojmë testimin me Pjesën 1, Testi i Leximit. Pasi të fillojmë, do të keni 65 minuta për të punuar në Pjesën 1. Do të kemi një pushim të shkurtër pasi të përfundojë pjesa. Do të postoj kohët e nisjes dhe ndaljes, dhe do të ju njoftoj kur të jemi afër mesit të Pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta.

Ju lutem hapni fletën e përgjigjeve të Pjesa 1. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 1 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër. Nëse e kaloni një pyetje për t'iu kthyer më vonë, sigurohuni të lini atë vijë të zbraztë në fletën e përgjigjeve. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur.

Nëse përfundoni para se të them se koha mbaroi, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit. Ju nuk humbni pikë për përgjigje të pasakta, kështu që përpiquni të përgjigjeni në secilën pyetje edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë.

Tani, hapni librin tuaj të testit në Pjesën 1. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Fat të mbarë, të gjithë.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

3.1 Gjatë Pjesës

Pas 30 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 35 minuta të mbetur në Pjesën 1.

Pas 60 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 1.

Pas saktësisht 65 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

3.1 Pjesa 1 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 1 të librit të testit.

65 MINUTA, 52 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 1 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.

UDHËZIMET

Çdo pasazh ose çift pasazhesh më poshtë pasohet nga një numër pyetjesh. Pas leximit të çdo pasazhi apo çifti pasazhesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për secilën pyetje duke u bazuar në çfarë është deklaruar apo nënkuptuar në pasazhin ose pasazhet dhe në ndonjë grafikë shoqëruese (siç janë tabelat apo diagramet).

3.1 Pas Pjesës 1

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni fletën e përgjigjeve në faqen e librit të testit ku keni ndalur punën. Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

Për pauzë, kujdestari juaj do të thotë:

Do të ndalemi për një pushim prej 10-minuta. Ju lutem dëgjoni me kujdes këto rregulla:

- Mos diskutoni pyetjet e testit me askënd ose mos përdorni asnjë lloj të pajisjeve elektronike gjatë këtij puhimi ose cilitdo pushimi tjetër gjatë testit.
- Nëse keni nevojë të largoheni nga klasa, shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, në korridor ose në banjo.
- Zamrat dhe pijet lejohen vetëm në zonat e destinuara.
- Ju lutem kini konsideratë për studentët që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht minutave.10

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

3.2 Deklarata e vërtetimit

Kur të gjithë studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:

Kur dorëzoni fletën e përgjigjeve pajtoheni se në çfarëdo rrethana nuk do të merrni jashtë dhomës së testimit asnjë pyetje të testit, t'ia jepni ato ndokujt, apo t'i diskutoni ato me ndokënd përmes çfarëdo mjeti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, postë elektronike, mesazhe tekstuale, ose internetit. Këto kushte ekzistojnë për t'u siguruar që të gjithë studentët të kenë një përvojë të drejtë dhe të barabartë. Këto kushte janë të shkruara në *SAT School Day Student Guide* e qasshme për të gjithë testuesit e SAT School Day dhe online në sat.org.

Nxirreni fletën e përgjigjeve por lëreni të mbyllur librin e testit. Dilni në pjesën e pasme të fletës së përgjigjeve dhe gjeni fushën e Certification Statement (Deklaratës së Vërtetimit). Pas leximit të paragrafit të kushteve në fund, kopjoni

deklaratën me stilin e zakonshëm të dorëshkrimit tuaj—bën edhe me shkronja shtypi ose stil kursiv. Pastaj nënshkruani emrin e plotë siç do ta bënit në një dokument zyrtar. Pranë nënshkrimit, shënoni datën e sotme. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Në vijim është përkthimi i Deklaratës Vërtetuese në anën e pasme të fletës së përgjigjeve. Kopjoni deklaratën në anglisht, jo përkthimin e dhënë këtu.

Vërtetohet se jam personi i listuar në fletën e përgjigjeve zotohem të respektoj kushtet e përgjithshme të SAT në *SAT School Day Student Guide*.

3.3 **Pjesa 2: Testi i Shkrimit dhe Gjuhës**



Koha standarde për Pjesën 2 është **35 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me Pjesën 2, Testi i Shkrimit dhe Gjuhës. Pasi të fillojmë, do të keni 35 minuta për të punuar në Pjesën 2. Do të postoj kohën e fillimit dhe ndaljes, dhe do të ju njoftoj kur jemi kah mesi i pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta.

Gjeni Pjesën 2 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 2 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.

Nëse përfundoni para se të them se koha mbaroi, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në Pjesën 2. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

3.3 **Gjatë Pjesës**

Pas 15 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 20 minuta të mbetur në Pjesën 2.

Pas 30 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 2.

Pas saktësisht 35 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

3.3 Pjesa 2 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 2 të librit të testit.

35 MINUTA, 44 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 2 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur në pyetjet e kësaj pjesë.

UDHËZIMET

Çdo pasazh më poshtë është i shoqëruar me një numër të pyetjeve. Për disa pyetje, do të konsideroni se si pasazhi do të mund të revidohej për të përmirësuar shprehjen e ideve. Për pyetjet tjera, do të konsideroni se si mund të redaktohet pasazhi për të korrigjuar gabimet në strukturën e fjalisë, përdorimin dhe shenjat e pikësimit. Një pasazh ose një pyetje mund të shoqërohet me një ose më shumë grafika (siç janë tabelat apo diagramet) që do ti konsideroni ndërsa merrni vendime për revidim dhe redaktim.

Disa pyetje do t'ju drejtojnë te një pjesë e nënvizuar e një pasazhi. Pyetje të tjera do t'ju drejtojnë te një vend në një pasazh ose do t'u kërkojnë të mendoni për pasazhin si tërësi.

Pas leximit të çdo pasazhi, zgjidhni përgjigjen për çdo pyetje që në mënyrën më efektive e përmirëson cilësinë e shkrimit në pasazh ose që e bën pasazhin të jetë në përputhje me konventat e anglishtes standarde të shkruar. Shumë pyetje e përfshijnë opsionin „NO CHANGE“ („NUK KA NDRYSHIM“). Zgjidhni atë opsion nëse mendoni se zgjidhja më e mirë është të lihet pjesa përkatëse e pasazhit ashtu si është.

3.3 Pas Pjesës 2

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni fletën e përgjigjeve në faqen e librit të testit ku keni ndalur punën. Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

3.4 Pjesa 3: Testi i Matematikës – Pa Kalkulator



Koha standarde për Pjesën 3 është **25 minuta**, me një pushim prej **5-minuta** në fund të pjesës. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me Pjesën 3, Testi i Matematikës pa Kalkulator. Pasi të fillojmë, do të keni 25 minuta për të punuar në Pjesën 3. Do të kemi një pushim të shkurtër pasi të përfundojë pjesa. Do të postoj kohët e nisjes dhe ndaljes, dhe do të ju njoftojë kur të jemi afër mesit të Pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta.

Kujdestari juaj do të thotë:

Gjeni Pjesën 3 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjonit përgjigjet tuaja në Pjesën 3 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.

Shumica e pyetjeve janë me zgjedhje të një përgjigjeje nga shumë të dhëna, por disa pyetje janë me përgjigje të prodhuara nga studentët. Udhëzimet për plotësimin e përgjigjeve tuaja në këto pyetje janë në librin e testit. Asnjëherë nuk do të ju nevojiten më shumë se 4 hapësira për të regjistruar përgjigjen tuaj, edhe pse disa përgjigje mund të mos përdorin të 4 hapësirat.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Edhe pse kjo është pjesa e matematikës, nuk ju lejohet të përdorni kalkulator në këtë pjesë të testit. Ju lutemi mbani kalkulatorin tuaj nën tavolinë përveç nëse jeni miratuar për të përdorur kalkulator 4 funksionësh si akomodim.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në Pjesën 3. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

3.4 **Gjatë Pjesës**

Pas 10 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 15 minuta të mbetur në Pjesën 3.

Pas 20 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 3.

Pas saktësisht 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

3.4 Pjesa 3 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 3 të librit të testit.

25 MINUTA, 20 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 3 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur në pyetjet e kësaj pjese.


UDHËZIMET

Për pyetjet 1-15, zgjidhni secilin problem, zgjedhni përgjigjen më të mirë nga opsionet e dhëna, dhe plotësoni fluskën korresponduese në fletën tuaj të përgjigjeve. Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelën në fletën e përgjigjeve. Ju lutemi referojuni udhëzimeve para pyetjes 16 se si të shënoni përgjigjen tuaj në tabelë. Mund të përdorni cilëndo hapësirë të disponueshme në broshurën e testit për punë përgatitore.

SHËNIME

1. Përdorimi i kalkulatorit **nuk lejohet**.
2. Të gjitha variablat dhe shprehjet e përdorura paraqesin numra real përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë test janë të vizatuara në shkallë të zvogëluar përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat shtrihen në rrafsh përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave real x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = l w$$





$$A = \frac{1}{2} b h$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$



Trekëndëshat e drejtë të veçantë




$$V = l w h$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3} \pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3} \pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3} l w h$$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

UDHËZIMET

Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelë, siç përshkruhet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

1. Edhe pse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në mbi kolona për të ju ndihmuar t'i mbushni saktë flluskat. Do të merrni pikë vetëm nëse flluskat janë të mbushura si duhet.
2. Mos shënjeni më shumë se një flluskë në cilëndo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të duhur. Në raste të tilla, në rrjet shënoni vetëm një përgjigje.
5. Numrat e përzier si $3\frac{1}{2}$ duhet të shënohen në rrjet si 3.5 ose 7/2. (Nëse $\frac{3\frac{1}{2}}{\circ\circ\circ\circ}$ shënohet në rrjet, do të interpretohet si $3\frac{1}{2}$, not $3\frac{1}{2}$.)
6. Përgjigjet decimale: Nëse merrni një përgjigje decimale me më shumë shifra se sa që mund të akomodojë rrjeti, mund të rumbullakësohet ose prehet, por duhet ta mbush tërë rrjetin.

Përgjigja: $\frac{7}{12}$ Përgjigja: 2,5

Shkruani përgjigjen në kuti.	7	/	1	2	Vizë thyese	2	.	5	Pikë decimale
	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
Rezultati në rrjet.	0	0	0	0	<input type="radio"/>	0	0	0	<input type="radio"/>
	1	1	1	1	<input type="radio"/>	1	1	1	<input type="radio"/>
	2	2	2	2	<input type="radio"/>	2	2	2	<input type="radio"/>
	3	3	3	3	<input type="radio"/>	3	3	3	<input type="radio"/>
	4	4	4	4	<input type="radio"/>	4	4	4	<input type="radio"/>
	5	5	5	5	<input type="radio"/>	5	5	5	<input type="radio"/>
	6	6	6	6	<input type="radio"/>	6	6	6	<input type="radio"/>
	7	7	7	7	<input type="radio"/>	7	7	7	<input type="radio"/>
	8	8	8	8	<input type="radio"/>	8	8	8	<input type="radio"/>
	9	9	9	9	<input type="radio"/>	9	9	9	<input type="radio"/>

Mënyrat e pranueshme për të lidhur $\frac{2}{3}$ janë:

2	/	3					
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9

.	6	6	6				
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9

.	6	6	7				
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9

Përgjigja: 201 – cilado pozitë është e saktë

2	0	1		
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0	0
1	1	1	1	1
2	2	2	2	2
3	3	3	3	3
4	4	4	4	4

2	0	1		
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0	0
1	1	1	1	1
2	2	2	2	2
3	3	3	3	3
4	4	4	4	4

SHËNIM:
Përgjigjet e juaja mun t'i filloni në cilindo kolonë, nëse e lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet lënë të zbrazëta

3.4 Pas Pjesës 3

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni fletën e përgjigjeve në faqen e librit të testit ku keni ndalur punën. Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

Për pauzë, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ndalemi për një pushim të shkurtë. Për pushim, nëse keni sjellë zamra, mund ta hani vetëm në zonat e dedikuara. Sikurse më parë, nëse ju duhet të largoheni nga klasa, mos shkoni askund tjetër përveç në hapësirat e dedikuara, në korridor, ose në banjo. Mos flisni në korridor, mos diskutoni pyetjet e testit me askënd, ose mos përdorni asnjë lloj të pajisjeve elektronike gjatë pauzës.

Do të fillojmë testimin sërish pas saktësisht 5 minutave.

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

3.5 Pjesa 4: Testi i Matematikës – Kalkulator



Koha standarde për Pjesën 4 është **55 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përktimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me Pjesën 4, Testi i Matematikës me Kalkulator. Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta për të punuar në Pjesën 4. Do t'i postoj kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit, dhe do t'ju njoftoj kur të kalojë gjysma e kohës së pjesës dhe kur të mbeten edhe minuta.5

Kujdestari juaj do të thotë:

Për këtë pjesë mund të përdorni kalkulator. Nëse keni kalkulator, ju lutem largoni mbulesën dhe vendoseni kalkulatorin në tavolinën tuaj tani. Mbani mbulesën e kalkulatorit në dysheme nën tavolinën tuaj gjatë testimit.

Edhe pse ju lejohet të përdorni kalkulator për këtë pjesë, mund të jepet përgjigje në të gjitha pyetjet pa kalkulator. Nëse përdorni kalkulator, mbani mend të ndiqni këto udhëzime:

- Mbani kalkulatorin rrafsh në tavolinën tuaj ose mbajeni ashtu që studentët tjerë të mos mund të shohin punën tuaj.
- Mos e ndani apo shkëmbeni kalkulatorin tuaj.
- Nëse keni kalkulator rezervë apo bateri, mbani në dysheme në tavolinën tuaj.
- Nëse kalkulatori juaj nuk funksionin dhe keni bateri ose kalkulator rezervë, ngriteni dorën. Do të afrohem për të ju ndihmuar. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni testin dhe bëni më të mirën që mundeni.

Gjeni Pjesën 4 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 4 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.

Shumica e pyetjeve janë me zgjedhje të një përgjigjeje nga shumë të dhëna, por disa pyetje janë me përgjigje të prodhuara nga studentët. Plotësoni këtë njëjtë siç keni bërë me pjesën e kaluar.

Kujdestari juaj do të thotë:

Nëse përfundoni para se të them se koha mbaroi, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk mund të shkoni në asnjë pjesë tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në 4. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

3.5 **Gjatë Pjesës**

Pas 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 30 minuta të mbetur në Pjesën 4.

Pas 50 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Keni edhe 5 minuta të mbetur në Pjesën 4.

Pas saktësisht 55 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

3.5 Pjesa 4 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 4 të librit të testit.

55 MINUTA, 38 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Kaloni në Pjesën 4 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur në pyetjet e kësaj pjese.


UDHËZIMET

Për pyetjet 1-30, zgjidhni secilin problem, zgjedhni përgjigjen më të mirë nga opsionet e dhëna, dhe plotësoni fluskën korresponduese në fletën tuaj të përgjigjeve. Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelën në fletën e përgjigjeve. Ju lutemi referojuni udhëzimeve para pyetjes 31 se si të shënoni përgjigjen tuaj në tabelë. Mund të përdorni cilëndo hapësirë të disponueshme në broshurën e testit për punë përgatitore.


SHËNIME

1. Përdorimi i kalkulatorit **lejohet**.
2. Të gjitha variablat dhe shprehjet e përdorura paraqesin numra real përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë test janë të vizatuara në shkallë të zvogëluar përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat shtrihen në rrafsh përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave real x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = l w$$





$$A = \frac{1}{2} b h$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$



Trekëndëshat e drejtë të veçantë




$$V = l w h$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3} \pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3} \pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3} l w h$$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

UDHËZIMET

Për pyetjet 31-38, zgjidhni problemin dhe shënoni përgjigjen tuaj në tabelë, siç përshkruhet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

1. Edhe pse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në mbi kolona për të ju ndihmuar t'i mbushni saktë flluskat. Do të merrni pikë vetëm nëse flluskat janë të mbushura si duhet.
2. Mos shënjeni më shumë se një flluskë në cilëndo kolonë.
3. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
4. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të duhur. Në raste të tilla, në rrjet shënoni vetëm një përgjigje.
5. Numrat e përzier si $3\frac{1}{2}$ duhet të shënohen në rrjet si 3.5 ose 7/2. (Nëse

3	1	/	2
○	○	○	○
○	○	○	○

 shënohet në rrjet, do të interpretohet si $31/2$, not $3\frac{1}{2}$.)
6. Përgjigjet decimale: Nëse merrni një përgjigje decimale me më shumë shifra se sa që mund të akomodojë rrjeti, mund të rumbullakësohet ose prehet, por duhet ta mbush tërë rrjetin.

Përgjigja: $\frac{7}{12}$

Shkruani përgjigjen në kuti.			
7	/	1	2
○	○	○	○
○	○	○	○
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

Rezultati në rrjet.

Përgjigja: 2,5

Pikë decimale			
2	.	5	
○	○	○	○
○	○	○	○
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

Mënyrat e pranueshme për të lidhur $\frac{2}{3}$ janë:

2	/	3
○	○	○
○	○	○
0	0	0
1	1	1
2	2	2
3	3	3
4	4	4
5	5	5
6	6	6
7	7	7
8	8	8
9	9	9

.	6	6	6
○	○	○	○
○	○	○	○
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

.	6	6	7
○	○	○	○
○	○	○	○
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

Përgjigja: 201 – cilado pozitë është e saktë

2	0	1
○	○	○
○	○	○
0	0	0
1	1	1
2	2	2
3	3	3
4	4	4

2	0	1
○	○	○
○	○	○
0	0	0
1	1	1
2	2	2
3	3	3
4	4	4

SHËNIM:
Përgjigjet e juaja mun t'i filloni në cilindo kolonë, nëse e lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet lënë të zbrazëta

3.5 Pas Pjesës 4

Kujdestari juaj do të thotë:

Mbyllni fletën e përgjigjeve ashtu që faqja 1 të jetë më së larti. Mbylleni librin tuaj të testit.

Tani kujdestari juaj do të thotë:

Para se të mbledh materialet tuaja të testit, ju lutem kthejeni përmbys fletën tuaj të përgjigjeve (ose dilni në faqen 16 nëse jeni duke përdorur fletën e madhe të përgjigjeve) dhe kontrolloni a keni plotësuar Form Code (Kodin e formularit) në fushën A. Ky Form Code (Kod i formularit) kërkohet për rezultatin e testit tuaj.

Kontrolloni a i keni plotësuar edhe fushat B deri D. Ju lutem ngriteni dorën nëse ju nevojitet ndihmë për të plotësuar cilëndo fushë.

Pas grumbullimit dhe numërimit të librave të testit kujdestari juaj do të thotë:

Nëse jeni duke bërë Esenë, vendoseni kalkulatorin nën tavolinë dhe vendoseni fletën e përgjigjeve me ballinë poshtë në tavolinën tuaj. Mund të bëni një pauzë të shkurtë për zgjatje të muskujve ndërsa i jap udhëzimet dhe mbledh nga studentët që kanë përfunduar testimin. Ju lutem mos flisni ose mos u largoni nga klasa pa leje.

Për studentët që janë duke bërë SAT-in pa Ese, kujdestari juaj do të thotë:

Ju që nuk jeni duke e bërë Esenë, urime, sapo përfunduat testin. Vendoseni fletën e përgjigjeve me ballinë lartë në tavolinën tuaj.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Tani dëgjoni këto informata të rëndësishme. Nëse doni të anuloni rezultatin tuaj para se të largoheni, ma kërkoni një formular Request to Cancel Test Scores, të cilin duhet ta plotësoni para se të largoheni nga klasa. Për të anuluar rezultatet e juaja më vonë, duhet ta njoftoni College Board-in me shkrim.

Nuk mund të anuloni rezultatin tuaj me një mesazh përmes postës elektronike ose një telefonate. Dërgoni kërkesën për anulim përmes postës brenda natës ose faksit, jo më vonë se ora 23:59 e Kohës Lindore në ditën e katërt të javës nga sot. Formularin mund ta gjeni edhe në internet në sat.org.

Nëse anuloni rezultatet tuaja, ato prapëseprapë do t'i dërgohen shtetit, por nuk do të dërgohen në kolegjet ose programet e bursave të zgjedhura nga ju e as të jenë në dispozicion në sistemin e raportimit të College Board.

Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse mendoni se do të donit të bëni ndryshime në fushën 15 në fletën tuaj të përgjigjeve, ku zgjidhni kolegjet dhe programet e bursave që doni të pranojnë rezultatet tuaja, ju lutem ngriteni dorën.

3.5 Plotësimi i Fushës së Raportimit të Rezultatit

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Për të bërë ndryshime se cilat kolegje dhe programe të bursave i pranojnë rezultatet tuaja, hapni fletën e përgjigjeve në faqen 2. Raportimet e rezultateve që i bëni tani do të jenë pa pagesë. Nëse nuk keni ndryshime, ju lutem qëndroni ulur në qetësi dhe lini fletën e përgjigjeve të mbyllur.

Për fushën 15, kujdestari juaj do të thotë:

Gjeni fushën 15 në faqen 2 të fletës suaj të përgjigjeve. Kur i nënshtroheni SAT-it si pjesë e SAT School Day, keni të drejtë t'ua dërgoni rezultatet e juaja deri 4 kolegjeve ose programeve të bursave. Nëse e plotësoni këtë pjesë opsionale,

rezultatet tuaja do të dërgohen pa pagesë. Rezultatet mund t'i dërgoni edhe më vonë për një taksë të vogël. Kolegjet dhe universitetet janë gjithnjë të interesuara të marrin rezultatet e studentëve, edhe nëse jeni gati të aplikoni.

Gjeni Score Reporting Code List (Listën e Kodeve për Raportimin e Rezultateve) në *Student Answer Sheet Instructions (Udhëzimet për Studentë për Fletën e Përgjigjeve)*. Përdorni këtë listë për të gjetur numrin 4 shifror për shkollat ose programet e bursave të cilave doni t'ua dërgoni rezultatet tuaja. Kolegjet dhe universitetet e SHBA-ve janë të listuara në radhë alfabetike sipas shtetit së pari. Pastaj vijojnë institucionet në territoret e SHBA-ve, të pasuara nga ato ndërkombëtare. Lista e fundit në këtë broshurë tregon programet e bursave të listuara sipas shteteve ose vendeve, në radhë alfabetike.

Për çdo vend ku doni të dërgoni rezultatet, kopjoni 4 shifrat në kuti dhe mbushni fluskat përkatëse (nëse përdorni fletë të përgjigjeve të mëdha, shtypni shifrat sa më qartë që mundeni). Më njoftoni nëse keni ndonjë pyetje.

Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Tani kujdestari juaj do të thotë:

Mbyllni Student Answer Sheet Instructions (Udhëzimet për Studentë për Fletën e Përgjigjeve) dhe fletën tuaj të përgjigjeve. Nëse jeni duke pritur për të bërë Esenë, sigurohuni që fleta juaj e përgjigjeve të jetë e kthyer me ballinë përmbys në tavolinën tuaj. Nëse keni përfunduar testimin, vendoseni fletën e përgjigjeve me ballinë të kthyer lartë në tavolinën tuaj që të mund ta kontrolloj kur ta grumbulloj.

3.5 Grumbullimi i Fletëve të Përgjigjeve

Për studentët që janë gati të lirohen, kujdestari juaj do të thotë:

Mbani mend, në çfarëdo rrethana nuk do të merrni jashtë dhomës së testimit asnjë pyetje të testit, t'ia jepni ato ndokujt, apo t'i diskutoni ato me ndokënd përmes çfarëdo mjeti, duke përfshirë, postës elektronike, mesazheve tekstuale, ose internetit. Siç kam thënë në fillim të testit, nëse një person shkel cilëndo nga këto politika që kanë të bëjnë me sigurinë e testit, rezultatet e tyre do të anulohen dhe atyre mund t'u ndalohet pjesëmarrja në testet tjera të College Board në të ardhmen.

(A) Nëse studentët kanë nevojë të mbledhin gjërat e tyre personale, kujdestari juaj do të thotë:

Ky administrim i testit tani ka përfunduar. Ndërsa përgatiteni të largoheni, ju lutem afrohuni dhe merrni gjërat e juaja personale të cilat i kam mbledhur nga ju më herët. Pasi të keni marrë të gjitha gjërat tuaja, mund të dilni nga klasa në qetësi. Ju lutem, mbani në mend se studentët në klasat tjera mund të jenë ende duke u testuar. Urime edhe njëherë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe për gjithë punën tuaj.

(B) Nëse studentët kanë të gjitha gjërat e tyre personale, kujdestari juaj do të thotë:

Administrimi i testit tani ka përfunduar. Mblidhni gjërat e juaja dhe dilni nga klasa me qetësi. Ju lutem, mbani në mend se studentët në klasat tjera mund të jenë ende duke u testuar. Urime edhe njëherë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe për gjithë punën tuaj.

3.6 Eeseja



Koha standarde për Pjesën Eeseja është **50 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ju jap nga një libër të Esesë secilit prej juve. Mos e hapni librin e Esesë deri të mos ju them ta bëni këtë.

Kujdestari juaj do të vazhdojë duke thënë:

Kur të merrni librin e Esesë kthejeni përmbys dhe shkruani me shkronja të shtypit mbiemrin, emrin dhe inicialin e mesëm, nëse keni. Pastaj shkruani me shkronja të shtypit kodin _____ dhe emrin _____ e kësaj shkolle dhe kodin (ose emrin) e kësaj klase testimi _____, të cilin e kam postuar për ju.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem hapni fletën e përgjigjeve të Pjesës 6. Nëse jeni duke përdorur një fletë të përgjigjeve të madhe, hapeni në faqen 30. Në anën e prapme të Librit të Esesë gjeni Essay Code (Kodin e Esesë). Kopjoni Essay Code (Kodin e Esesë) në fushën e fletës së përgjigjeve saktësisht siç paraqitet në anën e pasme të librit të Esesë dhe mbushni flluskën përkatëse. Kjo fushë duhet të plotësohet si duhet, ose eseja juaj mund të mos vlerësohet me pikë.

Kur të gjithë studentët të kenë një libër Eeseje, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ju jap disa udhëzime për të ju ndihmuar të siguroheni se eseja juaj do të vlerësohet saktë.

- Përdorni faqen planifikuese pa vija për të marrë shënime dhe planifikuar esenë tuaj. Asgjë që shkruani në faqen pa vija nuk do të vlerësohet për pikë.
- Kur të jeni gati, filloni të shkruani esenë tuaj në faqen e parë me vija, që thotë „Begin Your Essay Here” („Filloni Esenë Tuaj Këtu“). Shkruani esenë tuaj në këto faqe me vija dhe brenda margjinave të shënuara.
- Përdorni laps Numër 2. Nëse nuk përdorni laps, ose nëse i leni faqet e zbrazëta, do të vlerësoheni me zero pikë në Ese.
- Eeseja juaj duhet të përshtatet për ta zënë faqet e ofruara. Mos shkruani asgjë përtej fjalës “STOP” në faqen e fundit me vija, sepse çfarëdo e shkruar pas kësaj pike nuk do të vlerësohet për pikë.

Për të filluar Esenë, kujdestari i juaj do të thotë:

Tani do të kalojmë te Eeseja. Pasi të fillojmë, do të keni 50 minuta për të punuar në pjesën e Esesë. Do të postoj kohët e nisjes dhe ndaljes, dhe do të ju njoftoj kur të jemi afër mesit të Pjesës dhe kur të kenë mbetur 5 minuta. Mbani fletën tuaj të përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë.

Ju lutem mos e nënshkruani esenë tuaj ose mos shtoni emrin tuaj në të (si në „By Jane Doe“). Nëse e bëni këtë, kjo mund të vonojë rezultatin e esesë suaj.

Tani lexoni udhëzimet, pastaj kaloni te pyetja për Ese dhe filloni punën. Koha fillon tani.

3.6 Gjatë Esesë

Pas 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 25 minuta në pjesën e Esesë.

Pas 45 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në pjesën e Esesë.

Pas saktësisht 50 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë. Mbyllni fletën e përgjigjeve dhe librin e Esesë. Vendosni fletën e përgjigjeve me ballinën lart pranë librit të Esesë.

3.6 Udhëzimet e Librit të Esesë



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në pjesën e përparme të librit të Esesë.

UDHËZIMET

Eseja ju jep një mundësi për të treguar se sa në mënyrë efektive mund të lexoni dhe kuptoni një pasazh dhe të shkruani një ese duke analizuar pasazhin. Në esenë tuaj, duhet të demonstroi se e keni lexuar pasazhin me kujdes, të paraqitni një analizë të qartë dhe logjike dhe të përdorni gjuhën në mënyrë precize.

Eseja duhet të shkruhet në vijat e dhëna në fletën tuaj të përgjigjeve; përveç Faqes së Planifikimit të fletëve të përgjigjeve, nuk do të merrni letër tjetër për të shkruar në të. Do të keni hapësirë të mjaftueshme nëse shkruani në çdo vijë, shmangni margjinat e gjera dhe shkruani me dorë me një madhësi të arsyeshme. Mbani mend se atë që do të shkruani do ta lexojnë njerëz që nuk janë të mësuar me dorëshkrimin tuaj. Mundohuni të shkruani dhe të shtypni ashtu që të jenë të lexueshme për këta lexues.

PËRKUJTUES

- Mos e shkruani esenë tuaj në këtë broshurë. Vetëm ato që i shkruani në faqet me vija të fletëve tuaja të përgjigjeve do të vlerësohen.
- Eseja jashtë teme nuk do të vlerësohet

Keni 50 minuta (kohë standarde) për të lexuar pasazhin dhe shkruar një ese në përgjigje të udhëzimeve të dhëna brenda kësaj broshure.

KY LIBËR TESTI NUK DUHET TË LARGOHET NGA KLASA. RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR OSE PËRDORIMI I CILËSDO PJESE TË KËTIJ LIBËR TESTI ËSHTË I NDALUAR.

3.6 Pas Esesë

Kujdestari juaj do të thotë:

Urime, keni përfunduar testin. Ju lutem qëndroni ulur të qetë ndërsa i grumbulloj librat e Esesë.

3.6 Para lirit të studentëve

Pasi të numërohen të gjitha materialet, kujdestari juaj do të thotë:

Mbani mend, në çfarëdo rrethana nuk do të merrni jashtë dhomës së testimit asnjë pyetje të testit, t'ia jepni ato ndokujt, apo t'i diskutoni ato me ndokënd përmes çfarëdo mjeti, duke përfshirë, postës elektronike, mesazheve tekstuale, ose internetit.

Kujdestari juaj do t'ua përkujtojë studentëve pasojat duke thënë:

Siç kam thënë në fillim të testit, nëse një person shkel cilëndo nga këto politika që kanë të bëjnë me sigurinë e testit, rezultatet e tyre do të zhvlerësohen dhe atyre mund t'u ndalohet pjesëmarrja në testet tjera të College Board në të ardhmen.

(A) Nëse studentët kanë nevojë të mbledhin gjërat e tyre personale, kujdestari juaj do të thotë:

Ky administrim i testit tani ka përfunduar. Ndërsa përgatiteni të largoheni, ju lutem afrohuni dhe merrni gjërat e juaja personale të cilat i kam mbledhur nga ju më herët. Pasi të keni marrë të gjitha gjërat tuaja, mund të dilni nga klasa në qetësi. Ju lutem, mbani në mend se studentët në klasat tjera mund të jenë ende duke u testuar. Urime edhe njëherë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe për gjithë punën tuaj.

(B) Nëse studentët kanë të gjitha gjërat e tyre personale, kujdestari juaj do të thotë:

Administrimi i testit tani ka përfunduar. Mblidhni gjërat e juaja dhe dilni nga klasa me qetësi. Ju lutem, mbani në mend se studentët në klasat tjera mund të jenë ende duke u testuar. Urime edhe njëherë dhe faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe për gjithë punën tuaj.